


FILOZO FEMA

2025



SIMPOZIUMI "FILOZOFEMA"

Simpoziumi Ndërkombëtar Ndër/Trans Disiplinar për Filozofi,
Art dhe Teknologji

SYMPOSIUM "FILOZOFEMA"

International Inter/Trans Disciplinary Symposium for Philosophy,
Art and Technology



Drejtor i Simpoziumit:

Ridvan Emini

Udhëheqës Shkencor:

Labinot Kelmendi dhe Nehat Sadiku

Sekretarja e Simpoziumit:

Floriqe Xhemajli

Këshilli Shkencor:

Boris Groys (Universiteti i Nju Jorkut, SHBA)

Katerina Kolozova (Instituti për shkencat sociale dhe humanistikë, Maqedoni e Veriut,
Shkolla për hulumtim materialist, SHBA)

Alan Malachowski (Universiteti Stellenbosch, Afrikë e Jugut)

Vincent Blok (Universiteti i Roterdamit, Holandë)

Astrit Salihu (Universiteti i Prishtinës, Kosovë)

Hasnije Ilazi (Universiteti i Prishtinës, Kosovë)

Robert Roseberger (Georgia Tech, SHBA)

Blerim Latifi (Universiteti i Prishtinës, Kosovë)

Laurin Mackowitz (Universiteti i Grazit, Austri)

Luka Janes (Universiteti i Zagrebit, Kroaci)

Valon Leci (Universiteti i Prishtinës, Kosovë)

Luka Perusic (Universiteti i Zagrebit, Kroaci)

Taulant Gashi (Universiteti i Prishtinës, Kosovë)

Ismail Tasholli (Shoqata e Filozofëve të Kosovë, Kosovë)

Bordi Organizativ:

Labinot Kelmendi, Taulant Gashi, Nehat Sadiku, Ridvan Emini dhe Floriqe Xhemajli

Rreth Organizmit Ndihmuan:

Lekë Krasniqi, Drin Rukiqi, Fatjona Bahtiri, Zanë Rexha, Eugen Basha, Leon Sylejmani, Yll Bytyçi, Orik Begu dhe Altin Krasniqi

Dita e parë e simpoziumit: *The Question Concerning AI*

Në esun e tij "Question Concerning Technology" filozofi gjerman Martin Heidegger artikulon një pohim epokal nëpërmjet të cilit ai paralajmëron se teknologjia moderne nuk është thjesht një instrument neutral, por një "mënyrë e zbulimit" duke i konsideruar kështu të pamjaftueshme qasjet antropologjike dhe instrumentaliste mbi të kuptuarit e teknologjisë. Më pak se një shekull më vonë, jemi duke jetuar në një epokë e cila, sipas përcaktimit teorik të Heidegger nuk është epokë e teknologjisë sepse jetojmë me makinat inteligjente, por pikërisht është epokë e makinave inteligjente sepse jemi në epokën e teknologjisë. Inteligjenca artificiale është shndërruar në teknologjinë determinuese të epokës sonë – jo vetëm duke transformuar aspektet sipërfaqësore të mënyrës se si punojmë, komunikojmë, marrim vendime, por duke formësuar dhe riformësuar vazhdimisht edhe kategoritë klasike nëpërmjet të cilave e kuptojmë realitetin, të vërtetën, gjendjen njerëzore, botën dhe pozitën e njeriut në të. Megjithatë, në këtë shpërndarje të shpejtë të Inteligjencës Artificiale – pyetjet fundamentale filozofike ende japin kuptime ndryshe nga ato të zakonshmet mbi teknologjinë. Ndonëse, parashikimi apokaliptik i Heidegger se teknologjia po e riformëson në favor të kufizimit dhe kornizimit mënyrën se si e kuptojmë qenien po bëhet gjithnjë e më aktual – pyetja e cila duhet të shtrohet lidhur me epokën në të cilën po jetojmë është: Çfarë është, në të vërtetë Inteligjenca Artificiale përtej funksionit të saj teknik? Çfarë po na zbulon dhe çfarë po mban të fshehur? A ka hapësirë për një formë të re të të menduarit dhe cilat forma të të menduarit po dalin jashtë funksionit? Cila është esenca e inteligjencës artificiale dhe nëse ka një të tillë? A mund të flasim për një ko-ekzistencë të njeriut me makinat inteligjente? Çfarë përgjegjësie lindin kur jetojmë në një botë të shtuar dhe radikalisht të ndërmjetësuar? A ka hapësirë për një etikë të re në kohën e inteligjencës artificiale?

Duke u rikthyer në fundamendet teorike të hedhura nga mendimi i Heidegger dhe duke tentuar ta shtrijmë këtë mendim në kontekstet e reja të teknologjive të sotme, këtë vit, Simpoziumi për Filozofi, Art dhe Teknologji synon të krijojë një hapësirë reflektimi filozofik – që shkon përtej debateve teknike dhe angazhohet në pyetje më të thella të raportit njeri – teknologji sot. Nën titullin kryesor 'Question Concerning AI', ne ftojmë filozofë, artistë, teknologë, studiues kritikë, letrarë, politologë, shkrimtarë, njohës të fushës së Teknologjisë të dërgojnë punimet e tyre për këtë edicion të dytë të Simpoziumit "Filozofema".

First day of the Symposium: *The Question Concerning AI*

In his essay *The Question Concerning Technology*, the German philosopher Martin Heidegger articulates an epochal statement, warning that modern technology is not merely a neutral instrument but a "mode of revealing"—thereby deeming anthropological and instrumentalist approaches insufficient for understanding technology. Less than a century later, we are living in an era that, by Heidegger's theoretical definition, is not the age of technology because we live with intelligent machines—but rather, it is precisely the age of intelligent machines because we are in the age of technology. Artificial intelligence has become the defining technology of our epoch—not only transforming the superficial aspects of how we work, communicate, and make decisions but also continuously shaping and reshaping the classical categories through which we understand reality, truth, the human condition, the world, and humanity's place within it. Yet, amid this rapid proliferation of artificial intelligence, fundamental philosophical questions still yield meanings different from conventional ones about technology.

Although Heidegger's apocalyptic prediction—that technology is reshaping our understanding of being in favor of limitation and framing—is becoming increasingly relevant, the question that must be posed concerning the era we live in is: What, in truth, is artificial intelligence beyond its technical function? What is it revealing to us, and what is it keeping concealed? Is there room for a new form of thinking, and what forms of thinking are emerging beyond functionality? What is

the essence of artificial intelligence—if there is one? Can we speak of a co-existence between humans and intelligent machines? What responsibilities arise when living in an augmented and radically mediated world? Is there space for a new ethics in the age of artificial intelligence? Returning to the theoretical foundations laid by Heidegger's thought and attempting to extend it into the new contexts of today's technologies, this year's Symposium on Philosophy, Art, and Technology aims to create a space for philosophical reflection—one that goes beyond technical debates and engages with deeper questions about the human-technology relationship today. Under the main title *The Question Concerning AI*, we invite philosophers, artists, technologists, critical scholars, writers, political scientists, authors, and experts in the field of technology to submit their papers for the second edition of the "Filozofema" Symposium.

Simpoziumi “Filozofema” Ndër/Trans Disiplinar për Filozofi, Art dhe Teknologji III

DITA I : 20.10.2025

Tema: Question Concerning AI?

10:00 – 10:30 Regjistrimi i pjesëmarrësve dhe hapja e simpoziumit

Fjala hapëse

Prof. Dr. Bekim Baliqi – Dekan i Fakultetit Filozofik

Prof. Dr. Ass. Valon Leci – Shefi i Departamentit të Filozofisë

PHD.C. Ridvan Emini – Kryetar i Shoqatës së Filozofëve të Kosovës

Ass. PHD.C. – Nehat Sadiku – Bashkudhëheqës Shkencor i Simpoziumit

Paneli I: 10:30 - 11:30 - (Udhëheqës i Panelit - Labinot Kelmendi)

Vera Bühlmann (Universiteti i Vjenës, Austri)

“Të gjallëruar nga “përzemërsia” e dredhave: Vendi i shkrimit antropografik”

(Distinguished Speaker)

Luka Perusic (Universiteti i Zagrebit, Kroaci)

“Inteligjenca Artificiale mbi Fuqinë Shpëtuese” (Distinguished Speaker)

11:30 – 12:00 – Diskutimi

12:00 – 13:00 – Puaza e Drekës

Paneli II: 13:00– 14:00 - (Udhëheqës i Panelit – Taulant Gashi)

Labërie Leci (Universiteti i Lindenit, Holandë) “Rezistenca në shoqërinë e Kutisë së Zezë”

Ridvan Emini (Universiteti i Evropës Juglindore, Maqedoni e Veriut) “IA ndërmjet inovacionit dhe kontrollit:

Dilemat etike në rastin ‘Ministrja Diella’ dhe ‘kamerat inteligjente në Prishtinë’”

14:00 – 14:15 – Diskutimi

Paneli i III-të: 14:15 – 14:45 - (Udhëheqëse e Panelit – Florije Xhemajli)

Ana Ilievska (Universiteti Amerikan i Beirutit, Lebanon) – “Pse të studiojmë shkencat humane në epokën e inteligjencës artificiale (AI): Një perspektivë nga Evropa Juglindore dhe Mesdheu” (Distinguished Speaker)

14:45 – 15:00 – Diskutimi

15:00 – 15:30 – Kafe Pauza

Paneli IV-të: 15:30 – 16:30 - (Udhëheqës i Panelit: Luka Perusic)

Florije Xhemajli (Universiteti i Prishtinës, Kosovë) “Ta Mbajmë Pyetjen e Inteligjencës:

Drejt Logjikave të Reja të Rezistencës”

Jan Defranceski (Qendra Universitare për Bioetikë Integrative, Kroaci) “A mund të (ri)shkruajë

inteligjenca artificiale (IA) historitë sipas të cilave jetojmë? Perspektivë ekolinguistike mbi narrativat artificiale”

16:30 – 16:45 – Diskutimi

Paneli VI-të: 17:00 – 17:30 - (Udhëheqës i Panelit: Nehat Sadiku)

Keynote Speaker: Iain D. Thomson (Universiteti i Nju Meksikos, SHBA) – “Heidegger-i dhe Edukimi në Epokën e Inteligjencës Artificiale”

17:30 – 17:45 – Diskutimi

17:45 – Mbyllja e ditës së parë të simpoziumit

Abstraktet:

Të gjallëruar nga "përzemërsia" e dredhave:

Vendi i shkrimit antropografik

Vera Bühlmann (Universiteti i Vjenës, Austri)

Kumtesa ime do të marrë përsipër dhe do të ndjek një sugjerim që iu është ofruar filozofëve në një shkrim nga René Thom, matematikient dhe fizicist, sa i përket nocionit të Aristotelit mbi vendin. Propozimi i Thom-it është që ky nocion i vështirë të ndërlidhet me një mekanikë, që për Aristotelin rrjedh nga një lëvizje, vazhdimësia e së cilës nuk është as absolute dhe as nuk rrjedh nga ligjet natyrore; ajo ndodh "sipas vendit." Çështja që qëndron në zemër të studimit tim është se si të mendohet dallimi mes llojlojshmërisë (Manifold) dhe multiplicitetit (Multiplicity) (nocioni i Leibniz-it për Mannigfaltigkeit në relacion me Vielfalt, Vielzahl, Fülle në gjermanisht) - dy fjalë që në përgjithësi përdoren si ekuivalente sot në ligjërimi filozofike. Sugjerimi i Thom-it që Aristoteli të lexohet me rigorozitet si një topolog avant la lettre na shfaq një mënyrë për të eksploruar pikërisht këtë dallim, pra mes llojlojshmërisë dhe multiplicitetit, si një veprimtari e "mbajtjes" që është konstituive e "vendit." Ne e gjejmë të shënjuar këtu një rend tjetër simbolik të veprimtarisë njerëzore (një rend të amësisë, siç do të argumentoj) i cili e gjen veten në konstelacion me atë rend simbolik që quhet shpesh "Fallogocentric" (Phallogocentric). Pikërisht në lidhje me këtë propozim i René Thom-it na premtom kaq shumë: Lëvizja e kapur-për-vend e kontinuitetit që Aristoteli e kishte rezervuar për "vending" ndjek një mekanikë të shtojcës greke -phora (fora) (siç e gjejmë tek ana-fora, meta-fora, am-fora), ku e kemi një prefiks dreksional/pozicional - pherei, me kuptimin "të mbash, (në shqip kemi fjalën barra)", një folje që përshkruan aktin diskrecional (të mëvetsishëm, të lirë) të zhvendosjes së diçkaje sipas lëvizjes së vazhdueshme të "mbajtjes" të cilën e gjejmë të rezervuar për të qenit nënë, për amësinë (Nga rrënja PIE *Bher - (l) "Mbaj"; poashtu "Të jesh me barrë fëmije", cf. etymonline.com). Si ta mendojmë një "kontinuitet" të tillë? René Thom i qaset këtij problemi përmes një teoreme në matematikën bashkëkohore, të ashtuquajturën teoremë fundamentale të dredhës, të quajtur poashtu teorma Stokes. Duke u mbështetur mbi idenë e një ëcriture fëminine, unë do të konsideroj mekanikën e këtij soji të "bërjes së vendeve" përmes lenteve të filozofisë natyrore, dhe në harmoni me ligjërimi fëministe, duke e vëshguar atë si një lloj "shkrimi" që është thelbësisht intelektual dhe në të kohë i trupezuar. Unë sugjeroj të flasim për shkrimin antropografik dhe arkitektonik, që buron nga një sferë a-semantike (dhe poetike) (siç buron edhe ëcriture fëminine) - një sferë, siç do të argumentoj, e cila është specifikeisht e shenjuar si "matematike" në sensin para-modern (pra, nga matematika në greqisht, që do të thotë "gjithëcka që mund të mësohet" dhe mathematics (Matematika - në shqip) - "gjithëcka që i përket mësimit"). Duke ndjekur sugjerimin e Thom-it për të eksploruar më tej teormën e dredhave në lidhje me mendimin mbi "topos-in", dua të konsideroj një lloj të ndërmjetësismit (mediacy) në shkrim që është në harmoni dhe e frymëzuar nga notacioni dhe "çelësat" apo "partiturat" e "të bërit" matematikë si komponim. Në pyetje është një lloj i shkrimit që shpikë akomodimin e "së gjithës" projektive dhe përmblendhës, për të cilën vetëm matematika, sipas rrënjëve të saja filologjike, ka njohuri se si ta hartoj dhe ta gatitë për një lloj të "studimit" i cili nuk është vetëm "i afërt", parak dhe privativ, por edhe impersonal, universal dhe publik (metodik, ndërsujektiv).

Abstracts:

Animated by in the "Cordiality" of Curls: The Place of Anthropographical Writing

Vera Bühlmann (University of Vienna, Austria)

My talk will pick up and follow a suggestion we can find offered to philosophers in a text by René Thom, a mathematician and physicist, on Aristotle's notion of place. Thom's proposal is to relate a certain mechanics to this difficult notion, which for Aristotle unfolds from a motion whose continuity is neither absolute nor does it follow by law; it occurs "according to place". The subject matter at the heart of my study is how to think of the distinction between manifold and multiplicity (the Leibniz'ian notion of Mannigfaltigkeit in relation to Vielfalt, Vielzahl, Fülle in German) - two words which are largely used as equivalents today in philosophical discourses. Thom's suggestion of rigorously reading Aristotle as a topologist avant la lettre shows a way how to explore precisely this distinction, that between manifold and multiplicity, as a "holding" activity that is constitutive of "place". We find marked here an other symbolic order of human activity (one of motherhood, as I will argue) that finds its place in constellation with that symbolic order often deemed "phallogocentric". It is with regard to this that René Thom's proposal is so promising: The place-bound motion of continuity which Aristotle had reserved for "place" follows a mechanics of the Greek -phora (as we find it in ana-phora, meta-phora, am-phora), where we have a directional/positional prefix + -pherein, for "to carry, bear," a verb which relates the discretionary act of moving something to the continuous motion of "bearing" which we find reserved for motherhood (from PIE root *bher- (l) "to carry," also "to bear children", cf. etymonline.com). How to think of such "continuity"? René Thom approaches it through a theorem in recent mathematics, the so-called fundamental theorem for curls also called the Stokes Theorem. Drawing on the idea of an écriture féminine I will consider the mechanics of such place-making through the lens of natural philosophy, as well as in tune with feminist discourses, by regarding it as of a kind of "writing" that is as irreducibly intellectual as it is embodied. I suggest to speak of anthropographic and architectonic writing, welling from an a-semantic (and poetic) domain (as the écriture féminine does) – a domain, as I will argue, that is specifically marked as "mathematical" in the pre-modern sense (i.e. from Greek mathemata for "all that can be learnt", and mathematics, for "all that pertains to learning"). Following Thom's suggestion to explore the theorem of curls further in relation to "topos" thinking, I want to consider a kind of mediacy in writing that is tuned and spirited by notation and "keys" or "scores" of "doing" mathematics compositionally. At stake is a kind of writing that invents how to accommodate the projective and summational "all" which, according to its philological roots, mathematics alone knows how to scaffold and set-up for a kind of "study" that is not only "close", initiatory and privative, but also impersonal, universal and public (methodical, intersubjective).

Inteligjenca Artificiale mbi Fuqinë Shpëtuese

Luka Perusic (Universiteti i Zagrebit, Kroaci)

Në këtë prezentim, do të konsideroj integrimin e vazhdueshëm të sistemeve të IA në strukturat kulturore nga perspektiva e tensionit mes fuqive të dëmshme dhe atyre të dobishme të zgjedhës (Enframing), siç e paraqet Heidegger. Qëllimi i përgjithshëm është të kuptohet nëse shpikjet teknologjike që mund të transfigurojnë gjendjen themelore njerëzore, e pengojnë apo e mundësojnë fuqinë shpëtuese, dhe çfarë përfaqëson kjo fuqi. Në përpjekjen për të kapur mundësinë e realizimit të fuqisë shpëtuese, do të paraqes konceptin e teknocenit (technocene) si referencë historike kufizuese dhe do të analizoj mënyrën se si IA manifestohet në skenarët e mundshëm.

Artificial Intelligence upon Saving Power

Luka Perusic (University of Zagreb, Croatia)

In this presentation, I will consider the continuous embedding of AI systems into cultural structures from the perspective of the tension between the harmful and beneficial power of Enframing, as introduced by Heidegger. The overarching objective is to understand whether technological inventions that can transfigure the fundamental human condition withhold or grant saving power, and what that power could be. In the attempt to grasp the possibility of the saving power realized, I will posit the concept of technocene as the bounding historic reference and examine how AI plays out in the available scenarios.

Rezistenca në shoqërinë e Kutisë së Zezë

Labëri Leci - Msc Shkenca Politike, Universiteti Leiden (Holandë)

Me evolucionin e vazhdueshëm të përparimeve teknologjike, sistemet algoritmike kanë marrë një pozitë tepër të rëndësishme si ndërmjetës në mes njerëzimit dhe botës. Teksa transformojnë terrenin e shoqërisë sonë, ato gjithashtu nxjerrin në pah çështje sociale, politike dhe etike, duke përfshirë vet natyrën e tyre të paqartë, rrezikun e përkeqësimit të pabarazive dhe kërcënimin ndaj vlerave demokratike. Duke i pasur këto çështje parasysh, lindin shqetësime në lidhje me dinamikat e pushtetit midis këtyre sistemeve dhe shoqërisë në tërësi, e cila e ka gjetur veten të nënshtruar ndaj pushtetit algoritmik. Natyrisht, shqetësime të tilla çojnë në pyetjen: a mund t'i rezistohet pushtetit algoritmik dhe, nëse po, si? Duke u mbështetur në konceptin teorik të James C. Scott për rezistencën e përditshme, ky punim eksploron dy praktika përmes të cilave individët navigojnë dhe kundërshtojnë qeverisjen dominuese të algoritmeve. E para, praktikën mediatike të riparimit (Media Practices of Repair), ilustruhet nga faqja e internetit World White Web dhe arti i motorit të kërkimit Internet Imperialism, dhe tregon se si përdoruesit i rezistojnë paragjykimëve algoritmikë ndaj komuniteteve të marginalizuara duke riformuluar dhe ndikuar në rezultatet algoritmike. Praktika e dytë, lëvizja kundër face-recognition (njohjes së fytyrave), analizohet përmes projekteve artistike si kamuflazhi Hyperface dhe maska e printuar 3D URME Personal Surveillance Identity Prosthetic, të cilat fshehin fytyrat njerëzore për të sfiduar përhapjen e mbledhjes së të dhënave biometrike dhe survejimit. Ky eksplorim kontribuon në një kuptim më të gjerë të sfidave dhe mundësive për agjensi politike në një botë të ndërmjetësuar nga algoritmet.

Resistance in the Black Box Society

Labëri Leci – MSc Political Science, Leiden University (Netherlands)

With the continuous evolution of technological advancements, algorithmic systems have assumed a profound position as intermediaries between humankind and the world. While transforming our societal landscape, they also foreground social, political and ethical issues, including their opaque nature, the risk of exacerbating inequalities and the threat to democratic values. In light of these issues, concerns emerge about the power dynamics between these systems and society at large, which has found itself subject to algorithmic power. Naturally, such concerns lead to the question: can algorithmic power be resisted and, if so, how? Building on James C. Scott's theoretical concept of everyday resistance, this paper explores two practices through which individuals navigate and contest the prevailing governance of algorithms. The first, media practices of repair, is exemplified by the World White Web website and the Internet Imperialism search engine art, and demonstrates how users resist algorithmic bias against marginalised communities by reshaping and influencing algorithmic outputs. The second practice, the anti-face recognition movement, is examined through artistic projects such as the Hyperface camouflage and the URME Personal Surveillance Identity Prosthetic 3D-printed mask, which conceal human faces to challenge the proliferation of biometric data acquisition and surveillance. This exploration contributes to a broader understanding of the challenges and possibilities for political agency in an algorithmically mediated world.

IA ndërmjet inovacionit dhe kontrollit: Dilemat etike në rastin ‘Ministrja Diella’ dhe ‘kamerat inteligjente në Prishtinë’

Ridvan Emini (Universiteti i Evropës Juglindore, Maqedoni e Veriut)

Ky punim trajton dimensionet etiko-filozofike dhe normative të përdorimit të Inteligjencës Artificiale (IA) në qeverisje dhe siguri publike, duke analizuar dy raste konkrete në hapësirën shqiptare: ‘Ministrja virtuale Diella’ dhe instalimin e kamerave inteligjente në Prishtinë.

Nëpërmjet një qasjeje ndërdisiplinare, këtu ndërthuret filozofia klasike dhe bashkëkohore për të shqyrtuar ndikimin e IA-së në lirinë, privatësinë dhe përgjegjësinë njerëzore. Duke u mbështetur te Aristoteli, Heidegger, Jonas, Foucault, Floridi dhe Bostrom, kjo kumtesë paraqet tensionin midis efikasitetit teknologjik dhe virtytit moral. Pra, shqyrton se si teknologjia, në mungesë të një kornize etike dhe ligjore, mund të transformojë raportin mes shtetit dhe qytetarit, duke zhvendosur përgjegjësinë nga njeriu te algoritmi dhe duke riformuluar vetë konceptin e lirisë publike.

AI Between Innovation and Control: Ethical Dilemmas in the Cases of “Minister Diella” and “Smart Cameras in Prishtina”

Ridvan Emini (South Eastern University, North Macedonia)

This paper examines the ethical-philosophical and normative dimensions of Artificial Intelligence (AI) use in governance and public security, through an analysis of two concrete cases in the Albanian context: the virtual minister “Diella” and the installation of smart surveillance cameras in Prishtina.

Through an interdisciplinary approach, the study interweaves classical and contemporary philosophy to explore AI's impact on freedom, privacy, and human responsibility. Drawing upon Aristotle, Heidegger, Jonas, Foucault, Floridi, and Bostrom, this presentation articulates the tension between technological efficiency and moral virtue. It investigates how technology, in the absence of a coherent ethical and legal framework, can transform the relationship between state and citizen, shifting responsibility from the human agent to the algorithm, and thereby redefining the very concept of public freedom.

Pse t'i studiojmë shkencat humane në epokën e inteligjencës artificiale (AI): Një perspektivë nga Evropa Jugore dhe Mesdheu

Ana Ilievska (Universiteti Amerikan i Beirutit, Lebanon)

Që nga e ngritja e inteligjencës gjenerative (GenAI), dhe pretendimit të saj për mjeshtri në shkrim dhe përpunim informacioni, shkencat humane kanë filluar të përballen përsëri me një nga krizat e tyre të pafundme. Pse të merremi me letërsinë, filmin, artin, ose pse të shkruajmë, lexojmë, diskutojmë dhe hulumtojmë, kur e gjithë kjo tani vjen e paketuar paraprakisht, vetëm një klikim larg, dhe pa mundin e një fromimi të lodhshëm humanistik?

Kjo kumtesë do ta adresojë këtë pyetje duke u përqëndruar në fuqinë e letërsisë dhe arteve liberale, me theks të veçantë në shembuj nga Evropa Jugore dhe Mesdheu, për të skicuar disa shtigje të reja drejt së ardhmes për këtë fushë dhe për rajonin në epokën e e inteligjencës artificiale . Mendimi kritik, të qenit i matur dhe vlerësimi i asaj që disa e kanë quajtur “stili i jetesës mediterane” do të shërbejnë si udhërrëfyes përgjatë këtij rrugëtimi.

Why Study the Humanities in the Age of AI: A Southern European/Mediterranean Perspective

Ana Ilievska (American University of Beirut, Lebanon)

Since the rise of GenAI, its purported mastery over writing and information, the humanities have begun facing yet another of its infinite crises. Why engage with literature, film, art, or write, read, discuss, and do research when all this now comes conveniently prepackaged, just a click away, and without the effort of a tedious humanistic training?

This talk will address this question by focusing on the power of literature and the liberal arts, with particular emphasis on examples from Southern Europe and the Mediterranean, to chart a few pathways into the future for the field and the region in the age of AI. Critical thinking, moderation, and the evaluation of what some have called the Mediterranean lifestyle will serve as signposts.

Ta Mbajmë Pyetjen e Inteligjencës: Drejt Logjikave të Reja të Rezistencës

Florie Xhemajli (Universiteti i Prishtinës, Kosovë)

Ky prezantim merr si pikënisje librin *Morphing Intelligence: From IQ Measurement to Artificial Brains* të Catherine Malabou-së për të argumentuar nevojën e rimendimit të inteligjencës në epokën kognitive bashkëkohore, ku kufijtë mes natyrës dhe artificës, trurit dhe makinës, inteligjencës organike dhe asaj artificiale po bëhen gjithnjë e më të mjegullt. Për Malabou-në, inteligjenca nuk është më një hapësirë e mbrojtur ndërmjet biologjisë dhe simbolikes, por një proces morfues që artikullohet përmes bioteknologjisë, neuroshkencës dhe kibernetikës. Siç thekson ajo: "Një nga sfidat bashkëkohore themelore që koncepti i inteligjencës paraqet është ajo e angazhimit me marrëdhënien midis të gjallës dhe të pajetës në një aventurë që nuk është më rrëfimi i vjetruar i dallimit të tyre... Këto ndërmjetësime janë metamorfozat e inteligjencës, morfimi i saj historik". Zhvillimet në inteligjencën artificiale, ndonëse mbartin rrezikun e standardizimit dhe instrumentalizimit të mendimit, njëkohësisht hapin horizonte të reja konceptuale dhe imagjinative. Sfida teorike e shekullit XXI qëndron pikërisht në këtë ambivalencë: si të ndërtojmë logjika të reja rezistence pa mohuar potencialin e eksplorimit të konfigurimeve të reja të inteligjencës? Ky prezantim sugjeron se filozofia e Malabou-së ofron një kornizë kritike për të kapërcyer narrativat tradicionale dhe për ta rimenduar inteligjencën si një hapësirë të metamorfizmit historik, duke e vendosur këtë nocion në qendër të sfidave politike, etike dhe ekzistenciale të kohës sonë.

Keeping the Question of Intelligence: Towards New Logics of Resistance"

Flori Xhemajli (University of Prishtina, Kosovo)

This presentation takes Catherine Malabou's *Morphing Intelligence: From IQ Measurement to Artificial Brains* as its starting point to argue for a rethinking of intelligence in the contemporary cognitive era, where boundaries between nature and artifice, brain and machine, organic and artificial intelligence are increasingly destabilized. For Malabou, intelligence is no longer a protected domain between biology and the symbolic, but a morphing process articulated through biotechnology, neuroscience, and cybernetics. As she notes: "One of the fundamental contemporary challenges posed by the concept of intelligence is that of engaging the relation between the living and the nonliving in an adventure that is no longer the outdated story of their difference... These mediations are the metamorphoses of intelligence, its historical morphing."

Developments in artificial intelligence, while carrying risks of standardization and instrumentalization, simultaneously open new conceptual and imaginative horizons. The theoretical challenge of the 21st century lies precisely in this ambivalence: how can we construct new logics of resistance without denying the potential for exploring new configurations of intelligence? This presentation suggests that Malabou's philosophy offers a critical framework for moving beyond traditional narratives and for rethinking intelligence as a site of historical metamorphosis, placing this notion at the center of today's political, ethical, and existential challenges.

A mund të (ri)shkruajë inteligjenca artificiale (IA) historitë sipas të cilave jetojmë?

Perspektivë ekolinguistike mbi narrativat artificiale

Jan Defrančeski (Qendra Universitare për Bioetikë Integrative, Kroaci)

A mund të (ri)shkruajë inteligjenca artificiale (IA) historitë sipas të cilave jetojmë? Perspektivë ekolinguistike mbi narrativat artificiale

Abstrakt: Historitë brenda të cilave jetojmë formësojnë ekonomitë tona, politikat tona, madje edhe ekosistemet tona. Që nga supozimet mbi rritjen e pafundme e deri te narrativat e sundimit të njeriut mbi natyrën, këto "ekonarrativa" udhëheqin veprimin kolektiv - dhe shpesh në drejtime që janë ekologjikisht të paqëndrueshme.. Ekolinguistikët na kujtojnë se gjuha nuk është neutrale: fjalët që zgjedhim e strukturojnë marrëdhënien tonë me mjedisin, ndjesinë tonë të mundësisë dhe vetë mënyrën se si imagjinojmë të ardhmen. Por çfarë do të ndodhte nëse do të mundeshim në mënyrë të vetëdijshme t'i sfidojmë dhe t'i ridizajnojmë këto tregime? Inteligjenca artificiale hap një kufi të ri në këtë përpjekje. Duke analizuar trupa të mëdha tekstesh, IA mund të zbulojë modele të fshehura në rrëfimet që kemi trashëguar, të ekspozojë verbëritë ekologjike në historitë dominuese ekonomike dhe politike, dhe madje të gjenerojë rrëfime alternative që theksojnë ndërvarësinë dhe qëndrueshmërinë.

Më shumë sesa një mjet për efikasitet, IA bëhet një bashkëpunëtor në eksperimentimin narrativ - duke na lejuar të eksplorojmë se cilat rrëfime mund të mbështesin shoqëri që lulëzojnë në harmoni me botën natyrore. Ky prezantim eksploron mënyrën se si Inteligjenca Artificiale, e kombinuar me një perspektivë ekolinguistike, mund të na ndihmojë të hartojmë, kritikojmë dhe riimagjinojmë narrativat që strukturojnë jetën tonë. Do të shqyrtohen si potencialet transformuese, ashtu edhe rreziqet që lindin: sfidat etike të tregimeve të prodhuara algoritmikisht, rreziku i përforsimit të paragjyqimeve ekzistuese dhe tensionin ndërmjet kreativitetit kompjuterik dhe imagjinatës njerëzore. Qëllimi i prezantimit është të tregojë se si narrativat artificiale mund të kuptohen si korniza ekologjike, që ndërthurin gjuhën, teknologjinë dhe imagjinatën njerëzore.

Duke përdorur IA-në për të (ri)shkruar me vetëdije historitë me të cilat jetojmë, mund të zbulojmë rrugë drejt një mënyre të të menduarit ekonomik dhe një veprimi shoqëror që janë jo vetëm më të mençura, por edhe më të gjelbra, më gjithëpërfshirëse dhe më të ndjeshme ndaj botës së gjallë që na mban të gjithëve.

Can AI (Re)Write the Stories We Live By?

An Ecolinguistic Perspective on Artificial Narratives

Jan Defranceski (University Center for Integrative Bioethics, University of Zagreb, Croatia)

The stories we inhabit shape our economies, our politics, and even our ecosystems. From assumptions about endless growth to narratives of human dominion over nature, these "econarratives" guide collective action – and in many cases, in directions that are ecologically unsustainable. Ecolinguistics reminds us that language is not neutral: the words we choose frame our relationship with the environment, our sense of possibility, and the very futures we imagine. But what if we could consciously interrogate and redesign these stories?

Artificial intelligence opens a new frontier in this endeavour. By analysing massive bodies of text, AI can detect hidden patterns in the narratives we inherit, expose the ecological blind spots in dominant economic and political storylines, and even generate alternative narratives that highlight interdependence, resilience, and sustainability. More than a tool for efficiency, AI becomes a collaborator in narrative experimentation – allowing us to explore what stories might support societies that thrive in balance with the natural world.

This presentation explores how AI, combined with an ecolinguistic perspective, can help us map, critique, and reimagine the narratives that structure our lives. We will examine both the transformative potential and the pitfalls: the ethical challenges of algorithmically authored stories, the risk of amplifying bias, and the tension between computational creativity and human imagination. The presentation aims to show how artificial narratives can be understood as ecological frames, bridging language, technology, and human imagination. By harnessing AI to consciously (re)write the stories we live by, we may discover paths toward economic thinking and social action that are not only smarter, but greener, more inclusive, and more attuned to the living world that sustains us all.

Heidegger dhe Edukimi në Epokën e Intelejencës Artificiale

Iain D. Thomson (Universiteti i Nju Meksikos, SHBA)

Ky prezantim do të paraqesë shkurtimisht disa prej vështrimeve Heideggeriane dhe post-Heideggeriane të Thomson-it mbi sfidat e rrezikshme me të cilat përballet arsimi në “epokën e vonë moderne” të teknologjisë – apo në atë që tashmë quhet “epoka e inteligjencës artificiale” – si dhe vizionin e tij plotësues për përgjigjen më premtuese ndaj këtyre sfidave.

Heidegger and Education in the Age of AI

Iain D. Thomson (University of New Mexico, SHBA)

This talk will briefly present some of Thomson's Heideggerian and post-Heideggerian insights into the dangerous challenges facing education in our late-modern technological “age of AI” as well as his complementary vision of the most promising response.

Simpoziumi “Filozofema” Ndër/Trans Disiplinar për Filozofi, Art dhe Teknologji III

DITA II : 21.10.2025

Tema: Imazhi, Filmi dhe Filozofia

10:00 – 10:30 Regjistrimi në ditën e dytë të simpoziumit

Paneli I: 10:30 - 11:30 - (Udhëheqës i Panelit: Lum Çitaku)

Irena Kapović (Universiteti i Zagrebit, Kroaci), “Përjetimi i Joidentikes:

Adorno, Horrori dhe Estetika e Mediave”

Anila Sahiti (Universiteti i Prishtinës, Kosovë) “Gjak dhe Zorrë në Ekstremitetin e Lartë: një mbrojtje e Kinemasë Ekstreme (të Abjektit)”

11:30 – 11:45 – Diskutimi

11:45 – 12:30 – Dreka

Paneli II: 12:30 – 13:30 - (Udhëheqëse e Panelit: Anila Sahiti)

Lum Çitaku (RIT Kosova/Qendra Kinematografike e Kosovës, Kosovë)

“Kinemaja në mes të kthesës së inteligjencës artificiale”

Ivan Korolev (Universiteti i Zagrebit, Kroaci) “Koha dhe Kultura e Masës:

Nga Deleuze tek poststrukturalistët”

13:30 – 13:45 – Diskutimi

Paneli III: 13:45 – 14:45 - (Udhëheqës i Panelit: Taulant Gashi)

Albnor Sejdiu (Universiteti i Prishtinës, Kosovë) – “Magjepsja e Imazhit: Hermeneutika Intuitive”

Labinot Kelmendi (Universiteti i Prishtinës, Kosovë) “Skicë Konceptuale mbi Ikonpolin”

14:45 – 15:00 – Diskutimi

15:00 – 15:15 – Kafe Pauza

Paneli VI: 13:45 – 14:45 - (Udhëheqës i Panelit: Alexander Vojvoda)

Daniel Gönitzer (Universiteti i Gracit, Austri) “Vanilla dhe Primeval Biscuit:

Montazhi dhe Humori Grotesk ne Filmat e Alexander Kluge-së

(Distinguished Speaker)

15:45 – 16:00 – Diskutimi

16:00 – 17:30 – Roundtable Discussion/Film Screening: “Syri i Piliësës: Qasja Kinematografike e Alexander Kluge-s dhe Rëndësia e Saj në Kosovë”

Filmi: “Abschied von Gestern” (Në gjermanisht me titra në gjuhën shqipe)

Diskutimi: Alban Beqiraj, Alexander Vojvoda (Moderator), Blertë Ismajli, Verena Walzl

17:30 Mbyllja e Simpoziumit

Dita e dytë: Imazhi, Filmi dhe Filozofia

Imazhi ka qenë gjithmonë një prani e heshtur, por e qëndrueshme, në sfondin e përsiatjeve filozofike. Që nga antikiteti e deri më sot, ai ka qenë objekt debati ndër filozofë, duke ndikuar zhvillimin e aparaturave diskursive në rrafshet epistemologjike, ontologjike dhe estetike. Historia e filozofisë mund të shihet si një vallëzim i bakit (bakusit) me imazhin — një raport që, në epoka të ndryshme, ka prodhuar qasje të ndryshme teorike e kritike.

Në kohët moderne, imazhi nuk është më në periferi të përvojës sonë, por në qendër të saj. Imazhi teknik (Flusser) dhe ai digjital (Mitchell, Hansen) janë tashmë pjesë përbërëse e shoqërisë telematike dhe të asaj që mund të quajmë tekno-sferë. Në këtë kontekst, reflektimi mbi imazhin nuk është vetëm aktual, por i domosdoshëm. Ai prek sfida të shumta në estetikë, në teorinë e përfaqësimit, në teoritë e imazhit dhe në çështje ontologjike, epistemologjike e humanistike. Trupi social bashkëkohor është i ekspozuar ndaj ikonopolit (monopolit të imazhit) dhe imagokracisë — prandaj një analizë kritike mbi imazhin merr rëndësi të veçantë.

Diskursi mbi imazhin nuk është i kufizuar vetëm në filozofi. Edhe fusha si kritika letrare, studimet gjuhësore, sociologjia, psikologjia dhe antropologjia janë aktive në këtë debat, duke kontribuar me perspektiva të vlefshme dhe të domosdoshme për një kuptim sa më gjithëpërfshirës. Kinemaja, si forma paradigmatisht e imazhit modern, sfidon kategoritë klasike filozofike duke futur dimensione të reja si temporaliteti, afekti dhe riprodhimi teknologjik. Filozofët si Deleuze e kanë përkufizuar filmin si "imazh lëvizës", ndërsa Rancière e sheh atë si operacion mes "të thënshmes" dhe "dukshmes". Filmi është, pra, jo vetëm një formë arti, por edhe një fushë reflektimi që ndërvepron me zhvillimet teknologjike dhe shoqërore bashkëkohore.

Në këtë frymë, ftojmë studiues, kërkues dhe profesionistë nga disiplina të ndryshme që të kontribuojnë me punime origjinale që trajtojnë temat si:

- Imazhi në filozofi
- Kinemaja dhe filozofia: Deleuze, Rancière, Cavell etj.
- Imazhi teknik dhe digjital: përfaqësimi në epokën e teknologjisë
- Imazhi, Bio-Arti dhe sfidat e estetikës
- Teoria e imazhit dhe semiotika bashkëkohore
- Imazhi në letërsi, kritikë letrare dhe linguistikë
- Perspektiva sociologjike, antropologjike dhe psikologjike mbi imazhin dhe filmin

Second day: Image, Film, and Philosophy

The image has always been a silent yet persistent presence in the background of philosophical inquiry. From antiquity to the present day, it has been a subject of debate among philosophers, influencing the development of discursive frameworks in epistemological, ontological, and aesthetic domains. The history of philosophy can be seen as a bacchic dance with the image—a relationship that, across different eras, has produced diverse theoretical and critical approaches.

In modern times, the image is no longer on the periphery of our experience but at its very center. The technical image (Flusser) and the digital image (Mitchell, Hansen) are now integral components of telematic society and what we might call the techno-sphere. In this context, reflecting on the image is not only relevant but necessary. It touches upon numerous challenges in aesthetics, representation theory, image theories, and ontological, epistemological, and humanistic questions. The contemporary social body is exposed to iconopoly (the monopoly of the image) and imagocracy—making a critical analysis of the image particularly significant.

The discourse on the image is not limited to philosophy alone. Fields such as literary criticism, linguistic studies, sociology, psychology, and anthropology actively contribute to this debate, offering valuable and necessary perspectives for a more comprehensive understanding. Cinema, as the paradigmatic form of the modern image, challenges classical philosophical categories by introducing new dimensions such as temporality, affect, and technological reproduction. Philosophers like Deleuze have defined film as a "moving image," while Rancière sees it as an operation between "the sayable and the visible." Thus, film is not merely an art form but also a field of reflection that interacts with contemporary technological and social developments.

In this spirit, we invite scholars, researchers, and professionals from various disciplines to contribute original papers addressing topics such as:

- The image in philosophy
- Cinema and philosophy: Deleuze, Rancière, Cavell, etc.
- The technical and digital image: representation in the age of technology
- The image, bio-art, and the challenges of aesthetics
- Contemporary image theory and semiotics
- The image in literature, literary criticism, and linguistics
- Sociological, anthropological, and psychological perspectives on the image and film

Abstraktet:

Përjetimi i Joidentikes: Adorno, Horrori dhe Estetika e Mediave

Irena Kapović (Universiteti i Zagrebit, Kroaci)

Filozofi gjerman Theodor Adorno (1903–1969), një nga figurat qendrore të traditës së teorisë kritike marksiste, zë një vend të veçantë në historinë e mendimit filozofik. Përdorimi dhe riformulimi që ai i bën reflektimit dialektik dhe materialist të pararendësve të tij, qëndrimi kritik ndaj lartësimit të arsyes nga llluminizmi, si dhe themelimi i konceptit të "dialektikës negative", e kanë bërë veprën e tij të lexohet si një pararendje fragmentare e teorieve poststrukturaliste dhe postmoderniste. Distanca e tij ndaj pozitivizmit modern, e cila shfaqet në bindjen se realiteti është në vetvete i pakapshëm, mbështetet mbi pranimin e një "hendemku" të mbetur, i cili është njëkohsisht i dukshëm dhe i pakuptueshëm, pavarësisht përpjekjeve historike për ta përvetësuar racionalisht botën, pra pavarësisht përpjekjeve naive për ta shtrëmbëruar atë në mënyrë të pavetëdijshme për të ruajtur autoritetin epistemologjik të subjektit.

Ky hendek i paidentifikuar që ekziston në vetë realitetin – të cilin Adorno me të drejtë e quan "joidentitet" (nonidentity) – përndjek çdo sferë të veprimtarisë njerëzore. Duke iu shmangur njohjes dhe duke ekspozuar kufijtë e brishtë të fuqisë vetëpërsëritëse të të kuptuarit modernist, joidentiteti përndjek mendjen njerëzore, duke e përballur atë me pamjaftueshmërinë e vet. Mendja njerëzore, e prirur të kërkojë qëndrueshmëri dhe të shmangë pasigurinë, kërkon ngushëllim përmes "identifikimit" të botës, ndërkohë që "joidentiteti" – i kuptuar si një aspekt i realitetit që i reziston kapjes së plotë konceptuale – ngjall ndjesi paretatie dhe frike për shkak të natyrës së tij misterioze. Mediat shpesh demonstrojnë efektet psikologjike të "joidentitetit", veçanërisht brenda zhanrit të horrorit. Format i horrorit, i mbështetur mbi atë që është e fshehtë, e paqartë ose e pazgjidhur, shfrytëzon krijimtarinë mbizotëruese të mendjes dhe detyrimin intuitiv për të plotësuar boshllëqet aty ku mungon dijenia, duke projektuar siguri mbi të papërcjueshmën. Duke vepruar kështu, horror-i në mënyrë të papritur zbulon brishtësinë e metodologjisë epistemologjike pozitiviste, duke treguar prirjen e mendjes për të ruajtur korniza njohëse që ofrojnë koherencë, sidomos kur përballen me pasiguri shqetësuese. Ky tension shpërfaqet edhe në konceptin e Sigmund Freud-it për "das Unheimliche", ose "e guditshmjia", ku aspektet e njohura të realitetit paraqiten në mënyrë shqetësuese, duke provokuar paretati sepse tronditin kategoritë e vendosura të njohjes. Në thelb, "joidentiteti" në horror përngjan me një mospërputhje midis realitetit dhe aftësive të mendjes për ta parashikuar dhe kuptuar atë, duke e shtyrë audiencën të përballen me kufijtë e të kuptuarit të vet. Kështu, "joidentikja" mishëron një parim estetik kritik jo vetëm përmes paretatisë që ngjall, por edhe përmes ekspozimit radikal të brishtësisë epistimike që është e pandashme nga përpjekjet njerëzore për ta përshkruar botën si plotësisht të kuptueshme.

Abstracts:

Experiencing the Nonidentical: Adorno, Horror, and Media Aesthetics

Irena Kapović (University of Zagreb, Croatia)

The German philosopher Theodor Adorno (1903–1969) – a prominent figure within the intellectual framework significantly shaped by the tradition of Marxist critical theory – is distinguished by exceptional intellectual importance within the field of philosophical thought. His simultaneous adoption and redefinition of the dialectical and materialist reflection of his predecessors, his critical stance toward the Enlightenment's elevation of rationality, and his substantial establishment of "negative dialectics" have allowed his work to be interpreted as a fragmentary anticipation of poststructuralist and postmodernist theories. His critical distance from modernist positivism, manifested in his conviction that reality is inherently ungraspable, is grounded in a recognition of a residual "gap" – both conspicuously present and astonishingly incomprehensible – despite historical attempts at rational comprehension of the world, that is, despite the naive efforts of unconscious distortion of entities in order to affirm one's own epistemological authority. The unidentified gap inherent to reality – which Adorno rightly calls "nonidentity" – haunts every sphere of human activity. By eluding knowledge and exposing the fragile boundaries of the self-perpetuating power of modernist understanding, nonidentity haunts the human mind, confronting it with its own insufficiency. The human mind, predisposed to seek consistency and avoid uncertainty, seeks reassurance in "identifying" the world, while "nonidentity" – understood as an aspect of reality resistant to full conceptual apprehension – elicits a sense of unease and fear due to its mysterious nature. Media frequently demonstrates the psychological effects of "nonidentity", particularly within the horror genre. The horror format, grounded in what is hidden, ambiguous, or unresolved, exploits the mind's overpowering creativity and intuitive compulsion to fill gaps where knowledge is absent, projecting certainty onto the imperceptible. In doing so, horror abruptly exposes the fragility of positivist epistemological methodology, demonstrating the mind's compulsion to uphold cognitive frameworks which provide consistency, especially when confronted with unsettling uncertainty. Such tension is mirrored in Sigmund Freud's concept of "das Unheimliche", or "the uncanny", in which recognizable aspects of reality are displayed in an off-putting manner, provoking discomfort because they disturb the established categories of cognition. Principally, "nonidentity" in horror resembles as dissonance between reality and the mind's capabilities to predict and comprehend it, urging the audience to confront the limits of their understanding. Thus, the "nonidentical" embodies a critical aesthetic principle not only through unease, but also through a radical exposition of epistemic vulnerability inherent in human efforts to convey the world as fully intelligible.

Gjak dhe Zorrë në Ekstremitetin e Lartë: një mbrojtje e Kinemasë Ekstreme (të Abjektit)

Anila Sahiti (Universiteti i Prishtinës, Kosovë)

Elementet tabu në film, të cilat janë seksi dhe dhuna, shihen si tregues të kulturës së ulët dhe zakonisht lidhen me zhanret e horrorit dhe pornografisë. Megjithatë, ekziston një degë e kinemasë artistike, e cila i përdor të dy këta elementë në ekstremet e tyre, dhe e cila nuk përshatet në asnjërën prej këtyre dy kategorive, e cila quhet cinema du corps ose kinema 'ekstreme'. Ajo njihet me regjisorë të tillë si Catherine Breillat, Claire Denis, Coralie Trinh Thi dhe Virginie Despentes, Micheal Haneke, Lars Von Trier, Gaspar Noë që janë disa nga shumë fytyrat e kësaj forme të kinemasë. Ky punim pohon se filmat e kësaj forme janë të rëndësishëm në historinë e kinemasë për përfshirjen e këtyre elementëve, pasi ata formësojnë natyrën 'abjektive' të kësaj kinemaje, për të përdorur termin e Julia Kristeva-s. Tjetri abjektiv në këto filma përfaqësohet në formë të tabuve dhe transgresioneve shoqërore, të cilat na lejojnë që ne si shikues të takohemi me të çuditshmen (unheimlich) përmes një përvojë të pastër kinematografike. Ndërkohë që janë kritikuar në lidhje me përmbajtjen që shfaqin, si shumë të dhunshme ose pornografike, ky punim shqyrton mundësinë që këto filma synojnë të transformojnë mediumin, dhe marrëdhënien e mediumit me shikuesin, përmes këtyre dy elementëve që shfaqen në ekstrem (seks eksplicit, përdhunim, incest, vrasje, kanibalizëm). Duke përdorur konceptin e 'abjektit' të Kristeva-s, 'teatrit e mizorisë' të Artaud-së dhe nocionin e transgresionit të Georges Bataille-it, ky punim argumenton për ekzistencën e këtyre filmave dhe rëndësinë e tyre në historinë e kinemasë. Si rrjedhojë, duke parë regjisorët dhe filmat e tyre, mund të identifikojmë pesë elementë që formësojnë transformimin e mediumit të filmit dhe marrëdhënien e tij me audiencën. Para së gjithash, këto filma i sfidojnë shikuesit përmes imazheve që portretizojnë ndëshkimin e protagonistëve, atë që Antonin Artaud e quan një 'revoltë virtuale'. Së dyti, këto filma janë në thelb kritikë ndaj voyeurizmit të shikuesit (të parë në Cache dhe Funny Games të Haneke dhe Martyrs të Pascal Laugier). Së treti, ata janë kritikuar për shfaqjen e dhunës dhe eksplicititetit seksual; janë protestuar me largime nga kinemaja, janë censuruar përmes klasifikimeve dhe vlerësimeve, janë kufizuar dhe ndaluar. Së katërti, ato shfaqin "estetikën absorbuese trupore" (Tim Palmer) ose pasojat e të qenit/pasjes së një trupi. Dhe së fundmi, elementët 'ekstrem' nuk shfaqen të izoluar nga pjesa tjetër e filmit dhe as të izoluar nga zgjedhjet e tjera artistike (tingulli, pamjet, montazhi, lëvizjet e kamerës) të bëra në prodhimin e tyre.

Blood and Guts in High Extremity: a case for (Object) Extreme Cinema

Anila Sahiri (University of Pristina, Kosovo)

Taboo elements in film, which are sex and violence, are seen as tellers of low culture and are usually associated with the genres of horror and pornography. However, there is a branch of art cinema, which employs both of these elements to their extremes, and which does not fit into either of those two categories, which is called cinema du corps or 'extreme' cinema. With filmmakers such as Catherine Breillat, Claire Denis, Coralie Trinh Thi and Virginie Despentes, Micheal Haneke, Lars Von Trier, Gaspar Noë being some of the many faces of this form of cinema. This paper posits that the films of this form are important in the history of filmmaking for the inclusion of these elements, since they shape this cinema's abject nature, to use Julia Kristeva's term. The abjected other in these films is represented in forms of taboos and social transgressions, which allow us as viewers to be met with the uncanny (unheimlich) through a pure cinematic experience. While they have received criticism regarding the content they display, as being too violent or pornographic, this paper explores the possibility that these films intend to transform the medium, and the medium's relationship with the viewer, through these two elements which are displayed to their extreme (explicit sex, rape, incest, murder, cannibalism). Employing Kristeva's concept of 'abjection', Artaud's 'theatre of cruelty' and Georges Bataille's notion of transgression this paper makes a case for the existence of these films and their importance in the history of cinema. Consequently, it is through looking at the filmmakers and their films, we can pinpoint five elements which shape the transformation of the medium of film and its relationship with the audience. First of all, these films challenge the viewers through the images that portray the punishment of protagonists, what Antonin Artaud calls a 'virtual revolt'. Secondly, these films are inherently critical of the viewer's voyeurism (seen in Haneke's Cache and Funny Games and Pascal Laugier's Martyrs). Third, they have been criticized for their display of violence and sexual explicitness; they have been protested by walkouts, censored through classifications and ratings, restricted and banned. Fourth, they showcase the "absorbing corporeal aesthetics" (Tim Palmer) or the consequences of being/having a body. And lastly, 'extreme' elements are not shown in isolation from the rest of the film nor isolated from other artistic choices (sound, visuals, editing, camera movements) made in the production.

Kinemaja ne mes të kthesës së Inteligjencës Artificiale

Lum Çitaku (RIT Kosova/Qendra Kinomatografike e Kosovës, Kosovë)

Ky punim eksploron ndërthurjet ndërmjet filmit, filozofisë dhe teknologjisë përmes kornizës teorike të projektit tim kërkimor në zhvillim Ontological Epistemologies – Një Antropologji e Vetëdijes, Ndieshmërisë dhe Intimitetit në Zembrën e Kthesës së Inteligjencës Artificiale. Shprehja “epistemologji ontologjike” përdoret njëkohësisht me rreptësi konceptuale dhe me një lojë të qëllimshme ironike, duke sinjalizuar të pandashmen mes qenies dhe dijes së gjuhëzuar, ndërkohë që lejon një vetë-refleksivitet kritik në bashkimin e tyre.

Nga një këndvështrim antropologjik, kinemaja është më shumë se një formë arti, apo një objekt ose subjekt filozofik: ajo përbën një vazhdimësi të praktikave më të hershme njerëzore të shikimit dhe imagjinatës. Ëndrrat, në të cilat subjektet shpesh përtojnë botën nga një perspektivë e tretë apo jashtë trupit, e para-thënë në mënyrën kinematografike të perceptimit. Kinemaja e eksternalizon këtë formë të vizionit ëndërrimtar në një medium kolektiv, duke e shndërruar ndërgjegjen private në përvojë të përbashkët. Gjatë 130 viteve të fundit, ajo është bërë gjithashtu një hapësirë thelbësore për të eksploruar kulturat, kolektivitetet dhe format e vetëdijes që shfaqen përmes spektatoritetit, formimit të subjektit dhe intersubjektivitetit. Në këtë kuptim, kinemaja mund të kuptohet si një praktikë e vetëdijësueshmë (consciousnessing) (2022), koncept që e kam prezantuar në një ligjëratë mbi antropologjinë dhe letërsinë fantastiko-shkencore, për të përshkruar proceset e vazhdueshme përmes të cilave mënyrat e vetëdijes dhe të marrëdhënieve njerëzore konstituohen, ndërmjetësohen, çahen dhe riartikulojnë vazhdimisht. Këto procese nuk zhvillohen si gjendje të fiksuar, por si ndërlitime rekursive, ku të qenët dhe të diturit palosen brenda njëri-tjetrit.

Në veprën e Heidegger-it Question Concerning Technology, teknologjia identifikohet si një “mënyrë e zbulimit”, ndërsa koncepti i Glissant-it për opacitetin na kujton se jo të gjitha marrëdhëniet mund ose duhet të reduktohen në transparencë. Filmi, i vendosur në ndërthurjen midis teknologjisë dhe imagjinatës, i përfshin të dyja: ai merr pjesë në renditjen teknologjike të shikimit, por njëkohësisht ruan opacitetin, paqartësinë dhe teprinë. Ai e ndërpret kërkesën dominuese për transparencë, duke e riformuluar spektatoritetin jo si zotërim sovran, por si një fushë vështrimesh të ndërsjella, ku të shikuarit është po aq një akt i të qenit i shikuar. Në hyrjen tonë kolektive në epokën e inteligjencës artificiale, imazhet po bëhen gjithnjë e më shumë të parashikueshme, gjenerative dhe algoritmike. Megjithatë, kinemaja vazhdon të ofrojë burime për të menduar ndryshe: ajo e ndërpret logjikën e kapjes dhe të nxjerrjes përmes intensiteteve të saj afektive, temporale dhe shqisore. Duke u mbështetur si në kontekste lokale, si p.sh. imagjinatat kinematografike të Kosovës, ashtu edhe në regjimet globale të qarkullimit mediatic, ky punim argumenton se filmi ofron një perspektivë të privilegjuar për të kuptuar mënyrën se si njerëzit bashkëtojnë me makinat inteligjente – jo vetëm përmes përdorimit instrumental, por përmes marrëdhënieve, afektit, imagjinatës dhe përvojës intersubjektive. Në këtë kapacitet, kinemaja qëndron si njëkohësisht arkiv i ëndrrave kolektive të modernitetit dhe prag për të kuptuar, reflektuar dhe dokumentuar transformimet, logjikën ekstraktive dhe intersubjektivitetet që karakterizojnë epokën e inteligjencës artificiale. Ajo e realizon këtë jo përmes qartësisë, por përmes ndërprerjes, opacitetit dhe estetikës së pamjes së pjesshme.

Cinema in the Thick of the AI Turn

Lum Çitaku (RIT Kosova/ Cinematographic Centre of Kosovo, Kosovo)

This paper explores the intersections of film, philosophy, and technology through the framework of my ongoing research project Ontological Epistemologies – An Anthropology of Consciousness, Sentience, and Intimacy in the Thick of the AI Turn. The expression “ontological epistemologies” is employed both with conceptual rigor and with a deliberate playfulness, signaling the inseparability of being and language knowing while allowing a reflexive irony in their conjunction.

From an anthropological perspective, cinema is more than an art form, or a philosophical object or subject: it is a continuation of older human practices of vision and imagination. Dreams, in which subjects often experience the world from a third-person or out-of-body perspective, anticipate the cinematic mode. Cinema externalizes this form of dream-vision into a collective medium, turning private consciousness into shared experience. Over the past 130 years, it has also become a vital site for exploring cultures, collectivities, and consciousnesses as they can emerge through spectatorship, subject formation, and intersubjectivities. In this sense, cinema is also a practice of consciousnessing (2022), a concept I introduced during an anthropology and science-fiction lecture, to describe the ongoing processes through which modes of awareness and relation are continuously constituted, mediated, ruptured, and rearticulated. Such processes unfold not as fixed states but as recursive entanglements, where being and knowing are folded into each other.

Heidegger's The Question Concerning Technology identifies technology as a “mode of revealing,” while Glissant's concept of opacity reminds us that not all relations can or should be reduced to transparency. Film, situated at the intersection of technology and imagination, discloses both: it participates in the ordering of vision while also harboring opacity, ambiguity, and excess. It interrupts dominant demands for transparency, reframing spectatorship not as sovereign mastery but as a field of mirrored gazes, where seeing is always also being seen.

In our current collective entering into the AI epoch, images are increasingly predictive, generative, and algorithmic. Yet cinema continues to offer resources for thinking otherwise: it interrupts capture and extraction through its affective, temporal, and sensory intensities. Drawing from both local contexts such as Kosovo's cinematic imaginaries and global regimes of media circulation, this paper argues that film provides a privileged vantage for understanding how humans live with intelligent machines, not only through instrumental use, but through relation, affect, imagination, and intersubjective experience. In this capacity, cinema stands as both an archive of modernity's collective dreams and a threshold for grasping, reflecting on, and documenting the transformations, extractive logics, and intersubjectivities that characterize the AI age. It does so not through clarity but through interruption, opacity, and the aesthetics of partial view.

Koha dhe Kultura e Masës: Nga Deleuze te Poststrukturalistët

Ivan Korolev (Universiteti i Zagrebit, Kroaci)

Ky punim trajton konceptin e Gilles Deleuze-it për imazhin e kohës (time-image), i cili ofron një mënyrë të re të menduarit për kinemanë si formë të mendimit. Ndryshe nga kinemaja klasike, ku zinxhiri shkakor i veprimeve (movement-image) mbizotëron, imazhi i kohës paraqet një përfaqësim të drejtpërdrejtë të kohës që nuk i nënshtrohet veprimit. Në këtë lloj kinemaje, e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja ndërthuren, duke krijuar një “qendër virtuale” të perceptimit.

Ajo që është veçanërisht interesante është se si ky koncept filozofik mund të shqyrtohet në raport me kulturën e masës. Duke ndjekur intuiat poststrukturaliste, mund të argumentohet se imazhi i kohës pasqyron jo vetëm praktikatat artistike, por edhe transformimet shoqërore: forma të reja të përvojës, kujtesës dhe identitetit që formësohen përmes kinemasë. Në këtë kuptim, puna e Deleuze-it mund të lidhet me idetë e Roland Barthes dhe Jean Baudrillard, të cilët e analizuan kinemanë si pjesë të komunikimit masiv dhe të prodhimit simbolik.

Qëllimi i këtij punimi është të tregojë se koncepti i imazhit të kohës mundëson afrimin midis filozofisë dhe sociologjisë së kinemasë, duke hapur një perspektivë për ta kuptuar kinemanë jo vetëm si formë arti, por edhe si fushë që formëson perceptimin kolektiv dhe mitin kulturor.

Time and Mass Culture: From Deleuze to the Poststructuralists

Ivan Korolev (University of Zagreb, Croatia)

This paper discusses Gilles Deleuze's concept of the time-image, which offers a new way of looking at cinema as a form of thinking. Unlike classical cinema, where the causal chain of actions (movement-image) dominates, the time-image introduces a direct representation of time that is not subordinated to action. In such cinema, past, present, and future intertwine, creating a unique “virtual core” of perception. What is particularly interesting is how this philosophical concept can be examined in relation to mass culture. Following poststructuralist intuitions, it can be argued that the time-image reflects not only artistic practices but also social transformations: new forms of experience, memory, and identity that are shaped through cinema. In this sense, Deleuze's work can be connected to the ideas of Roland Barthes and Jean Baudrillard, who analyzed cinema as a part of mass communication and symbolic production.

The aim of this paper is to show that the concept of the time-image makes it possible to bring together the philosophy and sociology of cinema, opening a perspective for understanding cinema not only as an art form but also as a field that shapes collective perception and cultural myth.

Magjepsja e Imazhit: Hermeneutika Intuitive

Albnor Sejdiu (Universiteti i Prishtinës, Kosovë)

Në këtë punim, unë merrem me dy pyetje mbi natyrën e imazhit: se si është e mundur të kapim imazhin dhe se çfarë e bën atë të mundur në mendjen tonë. Përgjigja për të dyja këto pyetje është – (ndjenja që e quajmë) magjepsja. Por për të arritur në këtë përgjigje, punimi im hap shteg për një metodë të re kërkimore të quajtur “hermeneutika intuitive,” ku qëllimi kryesor është vëzhgimi i rrethit hermeneutik midis ndjenjave (Jung) tona dhe gjuhës (Wittgenstein) me të cilën i shënojmë dhe i interpretojmë ato. Me po të njëjtën metodë, do të hulumtohet tipologjia leksikore e ndjenjës së magjepsjes në greqishten e vjetër, posaçërisht Heraklitit (kalimi “*γοητεία*” në “*μαγεία*” atike, si dhe konstruktimin e “*ἐν+δαίμων*”); shqipen e vjetër (nga “magii” të Pjetër Bogdanit [1685] deri në shqipen moderne me “magjepsjen” e Çekrezit [1919]); anglishten e vjetër (“*enchauntemenz*” [1300] dhe “*enchantment*” [1350]) – ku më pas do të kalohet në shqyrtimin e shkurtër të “*enchantment*” të mbështetur në kërkimin e veprave të mbledhura të Hobbes-it, Locke-ut, Hume-it, Burke-ut dhe Scruton-it (shënim: prej Locke-ut deri te Scruton-i vetë, filozofët pajtohen me përgjigjen e punimit ndaj imazhit); dhe shkurtimisht norvegjishtes së vjetër me “*seiðr*” e “*galdr*,” pastaj në bërjen “*seiðgaldr*.” Përmes kësaj hermeneutike intuitive të katër gjuhëve për një ndjenjë të njëjtë, në fund do të arrihet suksesshëm përkufizimi i ndjenjës në fjalë si – “*frymëzimi* dhe *tërheqja* që e kemi përballë gjërave që kanë jetë më vete.” Me këtë përkufizim, do të vazhdohet më tej se si kjo ndjenjë bëhet zanafilla e “*artit të lartë*” me Fantazinë (“*enchantment*” – Tolkien dhe Ursula; “*circle of enchantment*” – Diana W. Jones). Se si është kjo ndjenjë, sipas filozofëve anglezë, që na ndihmon t’i kapim dhe e bëjnë të mundur imazhin (si mendor ashtu edhe atë digjital). Duke u përmbyllur i gjithë punimi në çudinë se çfarë kjo ndjenjë e udhëzon gjuhën tonë të gdhendet në praninë e imazhit, – si ajo gjë që mund të kapet [kuptohet] nga mendja dhe si ajo gjë që është e mundur të jetë [ekzistojë] fillimisht.

The Enchantment of the Image: Intuitive Hermeneutics

Albnor Sejdiu (University of Pristina, Kosovo)

In this paper, I address two questions concerning the nature of the image: how it is possible to grasp the image and what makes the image possible in our minds. The answer to both of these questions is – (the feeling we call) enchantment. But to arrive at this answer, my paper paves the way for a new research method called “intuitive hermeneutics,” where the main goal is to observe the hermeneutic circle betwixt our feelings (Jung) and the language (Wittgenstein) with which we mark and interpret them. With the same method, the lexical typology of the feeling of enchantment in Ancient Greek will be investigated, especially Heraclitus (the transition of “*γοητεία*” to the Attic “*μαγεία*,” as well as the construction of “*ἐν+δαίμων*”); Old Albanian (from Pjetër Bogdani’s “*magii*” [1685] to the Modern Albanian with Çekrezit’s “*magjepsje*” [1919]); Middle English (“*enchauntemenz*” [1300] and “*enchant-ement*” [1350]) – from where the attention will move to a brief examination of “*enchantment*” based on research into the collected works of Hobbes, Locke, Hume, Burke, and Scruton (note: from Locke to Scruton himself, philosophers agree on the paper’s answer to the image); and briefly in Old Norse with “*seiðr*” and “*galdr*,” then in the making of “*seiðgaldr*.” Through this intuitive hermeneutic of the four languages for the same feeling, finally and successfully the feeling in question will be defined as – “the inspiration and attraction that we have in the face of things that have a life of their own.” With this definition, it will be proceeded to how this feeling becomes the source of the “highest art” with Fantasy (“*enchantment*” – Tolkien and Ursula; “*circle of enchantment*” – Diana W. Jones). How it is this feeling, according to English philosophers, that helps us to grasp and make possible the image (both mental and digital). Concluding the whole paper in the wonder of what this feeling guides our language to frame itself in the presence of the image, – as that which can be grasped [understood] by the mind and as that which is possible to be [exist] initially.

Skicë konceptuale e Ikonopolit

Labinot Kelmendi (Universiteti i Prishtinës, Kosovë)

Duke pasur parasysh konceptin e “dromologjisë” të Paul Virilio, pra logjikën e shpejtësisë si shënjeshtë e shoqërisë hiper-moderne, mund të pohojmë se kjo logjikë ndikon edhe në fushën tonë të studimit. Kështu, format metodologjike të zbërthimit të një problematike nuk mund të jenë më të gjata, por kanë marrë formën e “mikrologjive” (Adorno), ose siç i quaj unë, skica – fraktura reflektive që përqendrohen rreth një problemi të caktuar.

Në këtë dritë-hije, ky prezantim ravijëzon Ikonopolin (qytetin hiper-modern) si nomos apo hapësirë liminale në kuptimin e Schmitt-it, ku manifestohen artifaktualitetet: teknologjia dhe imazheria, ndërkohë që media mbetet referenti ndërmjetësues mes tyre. Në këtë kuptim derridian, artifaktualiteti presupozon matricën e konstruktuar teknologjike dhe të mediatizuar të realitetit. Ikonopoli, si i tillë, është vendi ku ky artifaktualitet manifestohet — (artifact: fabrikim dhe aktualitet) — në kuptimin e qytetit si makinë-imazherike (sikurse në filmin Blade Runner). Këtu, imazhi është shkëputur nga historia e tij e reprezentimit dhe ka marrë një trajektore të re, në kuptimin që i jep Stiegler, si një “organ i memories dhe dëshirave kolektive.” Rrjedhimisht, Ikonopoli nuk përfaqëson më “rregullin për parkun njerëzor,” (Sloterdijk) por shndërrohet në ‘rregullin për parkun e deliriumit dhe kënaqësisë njerëzore’.

Conceptual Sketch on Iconopoly

Labinot Kelmendi (University of Pristina, Kosovo)

Taking into account Paul Virilio's concept of “dromology”—the logic of speed as a defining marker of hypermodern society—it can be argued that this logic also exerts an impact on our own field of study. Consequently, the methodological forms through which a problem is analyzed can no longer be extensive; instead, they have assumed the form of “micrologies” (Adorno), or what I call sketches—reflective fractures centered around a specific issue. In this chiaroscuro, the present paper delineates Iconopoly (the hypermodern city) as a nomos or liminal space in the Schmittian sense, where artifactualities—technology and imagery—manifest themselves, while media functions as their mediating referent. In the Derridean sense, artifactuality presupposes a technologically constructed and mediatized matrix of reality. Iconopolis thus becomes the site where this artifactuality is enacted—(artifact: fabrication and actuality)—conceived as an imaginary machine-city (as in Blade Runner). Here, the image has been detached from its history of representation and has taken on a new trajectory, in Stiegler's terms, as an “organ of collective memory and desire.” Consequently, Iconopolis no longer represents ‘the rule for the human park’ (Sloterdijk), but rather transforms into ‘the rule for human delirium and amusement’.

Vanilla Ice dhe Primeval Biscuit: Montazhi dhe Humori Grotesk në Filmat e Alexander Kluge-së

Daniel Gönitzer (Universiteti i Gracit, Austri)

Kinemaja e Alexander Kluge-së qëndron në udhëkryqin e urgjencës politike, reflektimit filozofik dhe lojës ekscentrike. Filmat e tij i rezistojnë kohercencës rrëfimtare, duke gjeneruar kuptim përmes ndërprerjeve — mes dokumentarit dhe fiksionit, teorisë dhe anekdotës, tragjedisë dhe komedisë. Në këtë kuptim, Kluge zgjeron teatrin epik të Bertolt Brecht-it në fushën e kinemasë: ndërprerja bëhet një mjet didaktik dhe emocional, një mënyrë për të prodhuar shikues që mendojnë, dhe jo thjesht që konsumojnë.

Në zemër të kësaj praktike montazhi qëndron humori grotesk i Kluge-së. Shpesh absurd, herë-herë i butë dhe gjithmonë i çorientueshëm, ai ekspozon kontradiktat e modernitetit, duke mbajtur gjallë një mbetje utopike të imagjinatës. Për Kluge-n, groteskja nuk është thjesht parodi, por një kundër-estetikë që minon logjikën racionalizuese të kapitalit dhe autoritetit.

Duke u mbështetur në një përzgjedhje veprash — nga filmat e tij të parë artistikë deri te eksperimentet televizive të mëvonshme — ky diskutim argumenton se montazhi dhe humori grotesk tek Kluge formojnë një kinema ndërprerjeje dhe largësie kritike. Në dialog me Walter Benjamin-in dhe Bertolt Brecht-in, Kluge zhvillon një gjuhë radikale kinematografike që insiston në fragmentin si kritikë dhe premtim.

Vanilla Ice and Primeval Biscuit Montage and Grotesque Humor in Alexander Kluge's Films

Daniel Gönitzer (University of Graz, Austria)

Alexander Kluge's cinema stands at the crossroads of political urgency, philosophical reflection, and eccentric play. His films resist narrative coherence, instead generating meaning through discontinuities—between documentary and fiction, theory and anecdote, the tragic and the comic. In this sense, Kluge extends Bertolt Brecht's epic theatre into the cinematic realm: interruption becomes a didactic as well as affective device, a way of producing spectators who think rather than merely consume.

At the heart of this montage practice lies Kluge's grotesque humor. Often absurd, occasionally tender, and always disorienting, it exposes the contradictions of modernity while keeping alive a utopian surplus of imagination. The grotesque, in Kluge's hands, is not merely parody but a counter-aesthetic that undermines the rationalizing logic of capital and authority. By drawing on selected works—spanning his early feature films to later television experiments—this talk argues that Kluge's montage and grotesque humor form a cinema of interruption and estrangement. In dialogue with Walter Benjamin and Bertolt Brecht, Kluge develops a radical cinematic language that insists on the fragment as both critique and promise.

At the heart of this montage practice lies Kluge's grotesque humor. Often absurd, occasionally tender, and always disorienting, it exposes the contradictions of modernity while keeping alive a utopian surplus of imagination. The grotesque, in Kluge's hands, is not merely parody but a counter-aesthetic that undermines the rationalizing logic of capital and authority. By drawing on selected works—spanning his early feature films to later television experiments—this talk argues that Kluge's montage and grotesque humor form a cinema of interruption and estrangement. In dialogue with Walter Benjamin and Bertolt Brecht, Kluge develops a radical cinematic language that insists on the fragment as both critique and promise.

Syri i Pilivesës: Qasja Kinematografike e Alexander Kluge-s dhe Rëndësia e Saj në Kosovë

“Filmi lind në mendjen e shikuesit”

— Alexander Kluge

Alexander Kluge (*1932) është një nga shkrimtarët, regjisorët dhe intelektualët publikë më me ndikim të Gjermanisë. Vepra e tij ndërthur letërsinë, kinemanë, televizionin dhe teorinë kritike. Gjatë studimeve për drejtësi në Marburg, Kluge u shoqërua me Theodor W. Adorno-n dhe shërbeu si këshilltar juridik në Institutin për Kërkime Shoqërore në Frankfurt. Falë ndërmjetësimit të Adorno-s, Kluge punoi në filmin *The Tiger of Eschnapur* të Hans Lang-ut. Këto përvojë të hershme, midis kinemasë autoriale dhe Teorisë Kritike, përcaktuan një karrierë të përkushtuar në riformësimin e formave të rrëfimit në kinema dhe televizion dhe, së bashku me Oskar Negt-in, në rishpikjen e sferave publike dhe të mënyrave të organizimit të përvojës. Si nënshkrues i Manifestit të Oberhausen-it në vitin 1962, Kluge u bë figurë qendrore e Neuer Deutscher Film (Kinemaja e Re Gjermane), një lëvizje e re kinematografike që theu kufijtë e prodhimit komercial dhe u angazhua në mënyre kritike me realitetin shoqëror e politik të Gjermanisë pas Luftës së Dytë Botërore.

Alexander Kluge u shfaq në ballë të Neuer Deutscher Film, duke sfiduar vazhdimisht normat konvencionale narrative dhe industriale dhe duke riformësuar mënyrën se si mund të rrëfehen historitë. Filmi i tij i parë artistik, *Yesterday Girl* (1966), fitoi Luanin e Argjendtë në Venecia, ndërsa *Artists Under the Big Top: Perplexed* (1968) u nderua me Luanin e Artë, duke vulosur rolin e tij si një nga figurat kryesore të kësaj lëvizjeje. Përmes kolazhit, zërit eseistik e poetik dhe montazhit të befasishëm, kfilmat e tij vënë në pyetje shoqërinë gjermane pas luftës dhe kufijtë e narratives komerciale. Duke përdorur montazhe, materiale arkivore, filma eseistikë dhe, më vonë, forma eksperimentale televizive, Kluge i trajton shikuesit si bashkautorë, duke ndërprerë vjimësinë e ngjarjeve për të mundësuar hapësira reflektimi dhe kritike.

Vepra e tij shqyrton formimin e sferave publike dhe kundërpublike brenda milisekondave, duke rishpikur mënyrat e pjesëmarrjes, kujtesës dhe përvojës në Gjermaninë e pasluftës dhe pas vitit 1968. Këto ndërhyrje lanë gjurmë të thella në praktikën e prodhimit dhe në mënyrën e pritjes nga publiku, sidomos në televizionin gjerman përmes kompanisë së tij DCTP (Development Company for Television Program), e cila krijoi hapësira të pavarura në orët e vona në kanalet private.

Programet e tij televizive, të ndërtuara nga intervista, materiale arkivore, tabela teksti dhe rikrijme kreative, e modeluan televizionin më shumë si një punëtori publike idesh sesa si rrjedhë pasive argëtimi. Ky projekt zgjeron interesin e tij të hershëm për krijimin e një “kundërsfere publike,” duke u dhënë hapësirë zërave të papërfaqësuar në art, shkencë, kulturë dhe politikë.

Vepra e gjerë e Kluge-s u prezantua në retrospektivën *The Assault of the Present on the Rest of Time* në Prishtinë (shkurt 2025). Një dosje e ardhshme e Jeta e Re për Kluge-n do të eksplorojë më tej rëndësinë e tij në Ballkanin Perëndimor. Kontributi i propozuar për Simpoziumin Filozofema synon të ndërtojë mbi këto diskutime.

Biografite

Alban Beqiraj ka studiuar Teatër, Film & Media dhe Filozofi në Kosovë dhe Austri. Që nga viti 2018, është bashkëthemelues i asociacionit kulturor “Stralli” në Kosovë. Ai ka drejtuar dhe ka bashkëpunuar në disa shfaqje teatrale në Prishtinë dhe Vjenë. Është themelues i shtëpisë botuese Logbook, shtëpi e re botuese shqiptare epërkushtuar ndaj letërsisë bashkëkohore dhe përkthimit, duke botuar klasikë të modernizmit dhe avangardës krahas zërave të rinj shqiptarë në dramë, prozë dhe ese kritike. Alban Beqiraj është drejtues i retrospektivës së Alexander Kluge-së *The Assault of the Present on the Rest of Time* në Prishtinë.

Alexander Vojvoda është një aktivist i medias komunitare dhe sociolog që punon në mbarëBallkanin Perëndimor. Praktika e tij ndërthur hulumtimin, iniciativat kulturore dhe mediat komunitare si mjete për pjesëmarrje, kujtesë dhe veprim. Ai eksploron mënyrën se si iniciativat mediatike, projektet e zërit dhe ato të vendosura në hapësira specifike, si dhe praktikën e kujtesës, mund të krijojnë kundërsferra publike dhe të analizojnë dialektikën e kujtesës. Alexander-i është i diplomuar në Sociologji (JKU Linz) dhe Komunikim Politik (Goldsmiths, Universiteti i Londrës). Ai është bashkë-organizator i retrospektivës së Alexander Kluge-së *The Assault of the Present on the Rest of Time* në Prishtinë.

Prof. Asoc. Dr. Blertë Ismajli është ligjgjuese në Linguistikën Gjermane dhe Gjermanishten si gjuhë e huaj në Departamentin e Studimeve Gjermane në Universitetin e Prishtinës. Ka doktoruar në Institutin e Studimeve Gjermane në Universitetin e Vjenës. Interesat e saj kërkimore përfshijnë morfo-sintaksën kontrastive, përkthimin e modalitetit, kontaktin gjuhësor shqip-gjerman dhe statusin e gjuhës gjermane në Kosovë në lidhje me migrationin. Ajo ka përkthyer në shqip veprën e Jürgen Habermas *Ein neuer Strukturwandel der Öffentlichkeit* dhe të deliberative Politik. Aktualisht shërben si shefe e departamentit, redaktore kryesore e revistës Filologjia dhe anëtare e bordit drejtues të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës. Ajo është bashkë-organizatore e retrospektivës së Alexander Kluge-së *The Assault of the Present on the Rest of Time* në Prishtinë.

Daniel Gönitzer, BA, MA, është asistent universitar (Prae Doc) në tfm | Department for Theatre, Film and Media Studies në Universitetin e Vjenës. Ka studiuar Filozofi dhe Letërsi Gjermane në Graz dhe Vjenë. Disertacioni i tij trajton marrëdhënien e Walter Benjamin-it me avangardën historike. Është gjithashtu aktiv në fushën kulturore në iniciativën Container 25 në Koruska/Karinthia. Ka botuar disa artikuj mbi Alexander Kluge dhe aktualisht është bashkë-redaktor i numrit të ardhshëm të Alexander Kluge Yearbook.

Verena Walz është artiste dhe shkrimtare, e diplomuar në Letërsi Gjermane dhe Histori të Artit (Universiteti i Graz) dhe në Skulpturë Tekstuale dhe Art Performativ (Academy of Fine Arts Vienna). Ka punuar si ligjgjuese e OeAD në Universitetin e Prishtinës. Praktika e saj kombinon tekstin, instalacionin dhe performancën, duke eksploruar feminizmin, gjuhën, marrëdhëniet njeri-kafshë dhe strukturat e pushtetit përmes qasjeve poetike dhe politike. Puna e saj akademike përfshin metafora të tokës në poezinë e Paul Celan-it, format negative në Land Art si figura të kujtesës dhe ndërthurjet njeri-natyrë, si dhe kuptimet kulturore dhe simbolike të kuajve në lidhje me gjininë dhe disiplinën. Ajo është bashkë-organizatore e retrospektivës së Alexander Kluge-së *The Assault of the Present on the Rest of Time* në Prishtinë.

The Dragon's Fly Eye: Alexander Kluge's Cinematographic Approach and Its Relevance in Kosovo

"The film emerges in the mind of the spectator"

— Alexander Kluge

Alexander Kluge (*1932) is among Germany's most influential writers, filmmakers, and public intellectuals whose work bridges literature, cinema, television, and critical theory. During his law studies in Marburg, Alexander Kluge befriended Theodor W. Adorno and served as legal counsellor to the Institute for Social Research in Frankfurt. Facilitated by Adorno, Alexander Kluge worked on Hans Lang's *The Tiger of Eschnapur*. These early encounters between author cinema and Critical Theory shaped his career committed to re-working narrative forms in cinema and television and together with Oskar Negt rethinking public spheres and the organization of experience. As a signatory of the Oberhausen Manifesto in 1962, he became a major figure of Neuer Deutscher Film (New German Cinema), a new cinematographic movement which broke with the boundaries of commercial film production and committing to critical engagement in the socio-political strata of post-WWII Germany. Alexander Kluge emerged at the forefront of the Neuer Deutscher Film, consistently challenging conventional narrative and industrial norms, reshaping how stories can be told. Alexander Kluge's debut feature film, *Yesterday Girl* (1966) won the Silver Lion at Venice. Artists Under the Big Top: Perplexed (1968) followed with the Golden Lion, cementing his reputation as a principal member of the Neuer Deutscher Film movement. Through collage, essayistic and poetic voice, and abrupt montage, these films interrogate postwar German society and the limits of commercial storytelling. Through montage-rich, archive materials, essayistic films and later experimental television, Kluge treats viewers as co-authors, interrupting seamless plots to open spaces for reflection and critique. His oeuvre probes the formation of public and counter-public spheres within milliseconds, reimagining participation, memory, and experience in post-war and post-1968 Germany. These interventions have left a lasting mark on production practices and audience reception, especially shaping television production in Germany with his DCTP (Development Company for Television Program), which produced independent late-night slots on private channels. His television programs, constructed from interviews, archives, text cards, and playful reenactments, modelled television as a public workshop of ideas rather than a stream of passive entertainment. The project extends his long-standing interest in creating a "counterpublic sphere," giving airtime to underrepresented voices in arts, science, culture, and politics. Kluge's wide-ranging work was presented at the retrospective *The Assault of the Present on the Rest of Time* in Prishtina (February 2025). A forthcoming Jeta e Re dossier on Kluge will further explore his relevance in the Western Balkans. The proposed contribution to the Filozofema Symposium seeks to build on these discussions.

Biographies

Alban Beqiraj studied Theatre, Film and Media Studies and Philosophy in Kosovo and Austria. Since 2018, he is co-founder of the cultural association "Stralli" in Kosovo. He directed and collaborated with several theater performances in Prishtina and Vienna. He is founder of the publishing house Logbook, a young Albanian publishing house dedicated to contemporary writing and translation, publishing modernist and avant-garde classics alongside new Albanian voices in drama, narrative, and critical prose. He is head of the Alexander Kluge Retrospective *The Assault of the Present on the Rest of Time* in Prishtina.

Alexander Vojvoda is a community media activist and sociologist working across the Western Balkans. His practice combines research, cultural initiatives, and community media as tools for participation, memory, and agency. He explores how media initiatives, sound and site-specific projects, and practices of remembrance can create counter-publics and explore the dialectics of memory. Alexander holds degrees in Sociology (JKU Linz) and Political Communications (Goldsmiths, University of London). He is co-organiser of the Alexander Kluge Retrospective *The Assault of the Present on the Rest of Time* in Prishtina.

Prof. Asoc. Dr. Blertë Ismajli is a lecturer in German linguistics and German as a foreign language at the Department of German Studies at the University of Prishtina. She holds a PhD from the Institute of German Studies at the University of Vienna. Her research interests include contrastive morpho-syntax, translation of modality, Albanian-German language contact, and the status of the German language in Kosovo and its correlation with migration. Among other projects, she has translated into Albanian Jürgen Habermas' *Ein neuer Strukturwandel der Öffentlichkeit und die deliberative Politik*. She currently serves as head of department, editor-in-chief of the journal "Filologjia" and is a member of the steering board of the National Library of Kosovo. She is co-organiser of the Alexander Kluge Retrospective *The Assault of the Present on the Rest of Time* in Prishtina.

Daniel Gönitzer BA MA is a university assistant (Prae Doc) at the tfm | Department for Theatre, Film and Media Studies at the University of Vienna. He studied Philosophy and German Literature in Graz and Vienna. His dissertation deals with Walter Benjamin's relationship to the historical avant-garde. Also active as a cultural worker in the cultural initiative Container 25 in Carinthia/Koroška. He has written several articles on Alexander Kluge and is currently co-editing the next issue of the Alexander Kluge Yearbook

Verena Walzl is an artist and writer, who graduated in German Literature Studies and Art History (University of Graz) and in Textual Sculpture and Performative Art (Academy of Fine Arts Vienna). She worked as OeAD lecturer at the University of Prishtina. Her practice combines text, installation, and performance, exploring feminism, language, human-animal relations and power structures through poetic and political approaches. Her academic work spans metaphors of earth in Paul Celan's poetry, negative forms in Land Art as figures of memory and human-nature entanglement, and the cultural and symbolic meanings of horses in relation to gender and discipline. She is co-organiser of the Alexander Kluge Retrospective *The Assault of the Present on the Rest of Time* in Prishtina



FILOZO FENIA

2025